



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 18/11

Prishtinë, më 06.07.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Albana Fetoshi.

Mungoi: Naser Osmani

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Avdiu-Zëvendësministër i Financave, Gani Gërguri-BQK, Betim Gjoshi dhe Miradije Meha-KQZ, Juergen Schatz, Ramadan Islami dhe Teki Shala-GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, datë 08.06.2011, 15.06.2011, 21.06.2011 dhe 22.06.2011;**
3. **Raportim nga Ministri i Financave për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2010, I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;**
4. **Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2010, I ftuar: Gani Gërguri, Guvernator i BQK-së;**
5. **Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010, E ftuar: Valdete Daka, Kryetare e KQZ – së;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2005/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr.04/L-009, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nr. 04/L-20, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L/010 për noterinë, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me tri pika, të cilat do të diskutohen në të ndryshme. Pika e parë ka të bëjë me formimin e grupit punues për PL për Ndhimë Shtetërore, pika e dytë ka të bëjë me raportin me amendamente për PL për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, përkatësisht me amendamentin 3, ku ka pasur dilema për çështjen e obligimit të raportimit financiar për shoqëritë tregtare dhe pika e tretë ka të bëjë me raportin e Komisioni lidhur me përmbushjen e detyrave që dalin nga plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian.

Rendi i ditës miratohet me plotësime në të ndryshme.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, datë 08.06.2011, 15.06.2011, 21.06.2011 dhe 22.06.2011

Kryetarja, shprehu vërejtje për procesverbalin e dt. 8.06.2011, te diskutimi i drejtorit ekzekutiv të AKP-së duke kërkuar nga stafi që të qartësohet më mirë komenti i tij.

Hykmete Bajrami, kërkoj sipas mundësive që procesverbalet e mbledhjes paraprake, të miratohen në mbledhjen e radhës, pasi që është vështirë të mbahen mend ato çfarë janë thënë para katër jave.

Kryetarja, u pajtua me parafolësen duke njoftuar se ka kërkuar nga stafi që procesverbalet të përgatiten për secilën mbledhje të radhës, mirëpo për shkak të dinamikës së punëve në komision dhe vonësës në përkthimin e tyre, nuk po arrihet që çdo javë të jenë të gatshme.

Procesverbalet miratohen pa ndryshime.

3. Raportim nga Ministri i Financave për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2010

Kryetarja, lidhur me detyrat e komisionit që dalin nga plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian në vështirësi të raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2010, theksoi që i janë dërguar shkresa Ministrisë së Financave për fushat që ajo është përgjegjëse dhe kemi marrë përgjigjet me shkrim, të cilat iu janë bashkangjitur rendit të ditës, së bashku me përgjigjet që kanë ardhur nga institucione tjera, si KRPP, APP, IKAP, si dhe Zyra e Kryeministrit. Kërkoj sqarime nga zëvendësministri për çështjen që ka të bëjë me funksionalitetin dhe kushtet e Bordit të Pavarur për

Rishqyrtime në shqyrtimin e ankesave, duke pasur parasysh që ky bord është zgjedhur me vonesë dhe si rezultat një numër i ankesave të parashtruara nuk janë shqyrtuar.

Ramadan Avdiu, njoftoi se bordi është themeluar me vonesë dhe si tillë është ballafaquar me mungesë të hapësirës dhe kushteve për punë, si dhe në mungesë të stafit profesional. Mirëpo tani, ky bord do të zhvendoset në një objekt tjetër. Gjithashtu këtij bordi i ka skaduar mandati dhe emrat janë propozuar për emërim në Kuvend. Këtij bordi domosdoshmërisht duhet t'i zgjidhet edhe stafi profesional, për t'i shqyrtuar ankesat e shumta që janë parashtruar para tij. Njoftoi anëtarët e komisionit për programin që ka të bëjë me modernizimin e sektorit publik, i cili do të zgjatë dy vite, përmes së cilit do të menaxhohen financat publike dhe hartimi i politikave.

Latif Gashi, lidhur me Bordin, pyeti se a ka Ministria ndonjë plan konkret për të ndërmarrë diçka urgjentisht apo janë këto vetëm plane pa afat?

Hykmete Bajrami, ndër çështjet tjera që është kërkuar sqarim nga Kryetarja e Komisionit, është edhe procedimi i PL për prokurimin publik dhe PL për financimin e partive politike, për të cilat është thënë se do të procedohen në qershor. Qeveria po mundohet t'ia hedh fajin Kuvendit nëse nuk është efektiv në përmbushjen e legjislaturës dhe si rezultat raporti do të jetë negativ. Sugjeroi Qeverinë të punojë më shumë dhe të procedojë me kohë projektligjet, kur dihet se këto projektligje po vijnë në një nivel jo të kënaqshëm, për çka po merr shumë kohë për ndryshimin dhe plotësimin e tyre, siç është rasti me PL për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Pyetja e dytë është rreth nevojës për implementimin e ligjeve, siç është rasti i PL për prokurimin publik, megjithëse është miratuar vitin e kaluar, raporti i progresit thotë se nuk është i plotë dhe i nivelit të duhur, apo rastin e prokurimeve publike të cilat e anashkalojnë agjensionin e prokurimit publik, çfarë po bëhet në këto drejtime?

Kryetarja, lidhur me procedimin e projektligjit për prokurim publik dhe për financimin e subjekteve politike, njoftoi se kërkesa i është drejtuar Zyrës së Kryeministrit, pasi që ajo është sponzoruese dhe afatet e parapara në strategji legjislative janë afate për dorëzimin e projektligjeve në Qeveri dhe jo në Kuvend.

Sali Asllanaj, theksoi si pikë të dobët procesin e planifikimit dhe mungesën e projekteve afatgjate. Në vendin tonë dokument i vetëm është KASH-i, i cili nuk është një dokument strategjik i zhvillimit. Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik duhet tu japë shtytje më të madhe të gjitha ministrive, që të bëjnë strategji zhvillimore dhe në kuadër të saj të bëhen plane afatmesme dhe afatgjata. Siç shihet raporti i progresit për vitin 2011, do të jetë edhe më i pafavorshëm. Do të duhej që qeveria të ketë një trup koordinues, me të cilin do të harmonizohen prioritetet zhvillimore dhe pyeti se a ka qeveria një trup koordinues të tillë?

Muhamet Mustafa, theksoi për këto që janë paraqitur si përgjigje më tepër janë arsyetim që i kundërshtojnë vlerësimet. Në KASH, gjendja nuk është përmirësuar pasi që ende i kemi dy skenarë në parashikimet në rritjes ekonomike. Do të duhej angazhim më i madh në zgjidhjen e problemeve dhe mos të kalohen kështu gjërat e rëndësishme, vetëm duke dhënë arsyetime. Të gjithë jemi të interesuar që raportet e progresit të dalin më të mira, mirëpo duhet qasur në formë tjetër problemeve dhe të punojmë për përmisimin e situatës ekonomike.

Xhevdet Neziraj, shprehu shqetësimin për gjërat e njëjta që po paraqiten në raport duke pasur ndryshime shumë të vogla në këtë drejtim. Problemi me planifikimin po vazhdon, do të duhej të disiplinohen agjensionet buxhetore në shpenzimin e mjeteve. Një problem tjetër është vonesa e procedimit të projektligjeve që rregullojnë tregun financiar dhe bursën dhe deri sa nuk i kemi këto

mjete, do të kemi pengesa ligjore në kthimin e parave të trustit pensional apo të AKP-së, të cilat do të ndikonin në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Për këtë çështje të gjitha institucionet duhet dhënë kontributin e vet në fushën e përgjegjësisë që kanë.

Ramadan Avdiu, e para që duhet bërë është të kompletohet bordi, me anëtarë të rinj, ndërkaq ministria përveç sigurimit të zyreve, në mandatin e vet duhet të sigurojë kushtet që ky bord të jetë eficient. Sa i përket çështjeve tjera të ngritura, tani së fundi ka filluar të implementohet projekti për modernizimin e sektorit publik, që do ndihmojë në modernizimin dhe menaxhimin e financave publike në linjën qeveritare, që do të ndihmojë edhe në hartimin e politikave konsistente. Po ashtu ekziston zyra për planifikime strategjike dhe zyra koordinuese, që merret me punët e planifikimit dhe politikave zhvillimore, megjithëse duhet përmisuar situatën në çështjet planifikuese. Në Ministrinë e Financave, po përpiqemi që komitetin për investime publike, ta bëjmë më efektiv dhe ta ruaj një harmoni të zhvillimit në gjithë Kosovën, ku do të ketë një shtrirje në të gjitha organizatat buxhetore. Raportet e progresit fokusohen në pikat e dobëta, dhe një gjë e tillë po ndodhë për të gjitha vendet e Ballkanit dhe kjo është një obligim për ne që të përmirësojmë performancën në përmbushjen e kriterëve dhe kushteve për zhvillim dhe integrim. Sa i përket nevojës për ekzistimin e ligjeve që kompletojnë tregun financiar dhe të kapitalit, mbështes iniciativat e përbashkëta për hartimin e këtyre projektligjeve dhe Ministria e Financave do të jep kontributin e vet, që të krijohet baza ligjore për investimin e mjeteve nga privatizimi dhe të trustit në ekonominë e vendit.

Kryetarja, kërkoi për çështjet që janë ngritur në komision dhe në Kuvend me rastin e shqyrtimit të KASH-it, përfshirë edhe mendimet që u paraqiten këtu dhe mendimi i z. Mustafa për ekzistimin e dy skenarëve, të merren parasysh nga Qeveria me rastin e azhurnimit të KASH-it dhe hartimit të buxhetit vjetor. Njëkohësisht të ndërmerren masa për funksionalizimin e Bordit dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe që në atë Bord të propozohen anëtarë që i plotësojnë kushtet dhe të bëhet funksional.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2010

Kryetarja, theksoi që raporti i BQK-së është gjithëpërfshirës ku janë të pasqyruara edhe të arriturat që janë bërë gjatë vitit 2010 dhe nivelin e zhvillimit ekonomik në Kosovë. Janë disa tregues në lidhje me zhvillimet të cilat kanë ndodhur në ekonominë botërore. Nga raporti shihet se në vitin 2010 ka pasur rritje reale të brutoproduktit prej 4%, si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve në sektorin privat. Ka pasur rritje të depozitave, mirëpo depozitat kanë qenë kryesisht të ekonomive familjare dhe pak të ndërmarrjeve. Edhe më tutje po vazhdon trendi i njëjtë te bankat komerciale, ku asetet e tri bankave kryesore arrijnë vlerën afër 77%. Shihet se ka rritje të eksportit dhe importit, po ende është i lartë deficitin në llogarinë rrjedhëse. Me interes do të ishte të kemi informata direkte nga Guvernatori lidhur me mbikëqyerjen e institucioneve mikrofinanciare dhe se çka po ndodhë me fondet pensionale. Në fund shohim raportin e auditorit të pavarur për pasqyrat financiar të BQK-së, ku konstatohet se nuk ka pasur shkelje. Në vazhdim e pyeti Guvernatorin se kur do të fillojë emitimi i letrave të para me vlerë, pasi për dallim nga BQK, nga Ministria jemi informuar se do të fillojë në kuartalin e katërt.

Gani Gërguri, njoftoi se sektori financiar gjatë vitit 2010 ka qenë stabil, mirëpo ndërmjetësimi financiar nuk ka pasur ndryshime pozitive në shkallën e kostos, inflacioni ka qenë pak a shumë në linjë me inflacionin në zonën e euros, ndërkaq deficitin buxhetor dhe borxhi publik kanë qenë në suaza modeste duke pasur parasysh përqindjen e prodhimit të brendshëm. Sistemi bankar ka pasur rol të rëndësishëm në financimin e konsumit të investimeve në vend, kreditimi i bankave i është rikthyer rritjes dy shifrore prej 13.2 % në krahasim me vitin 2009 që ka qenë 8.9%, mirëpo shpërndarja sektoriale e kredive ka qenë pothuajse e njëjtë me dominim të sektorit të shërbimeve rreth 70 % dhe

sektorit të bujqësisë me pjesëmarrje vetëm prej 3.7%. Sipas BQK-së aktivitetet prioritare për vendin tonë kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit për biznes, gjenerimi i kapaciteteve më të mira planifikuese në të gjitha nivelet, gjenerimin e kapaciteteve vendimmarrëse si të akterëve në sektorin publik ashtu edhe të atyre në sektorin privat. Në sektorin real është i domosdoshëm rritja e prodhimit vendor, e sidomos ai bujqësor. Sa i përket sektorit të jashtëm, Kosova vazhdon me normë të lartë të deficitit tregtar, sidoqoftë rritja më e shpejtë e eksporteve në krahasim me importet ka sjellë për herë të parë deri në shkallën e mbulimit të importeve me eksporte në vlerë prej 13.7%. Sidoqoftë, rritja e importeve ka reflektuar rritjen e kërkesës në Kosovë, por edhe rritjen e çmimeve në tregjet e jashtme. Struktura e importeve dominohet nga mallrat e konsumit rreth 48%, ndërsa importet e mallrave kapitale janë të ulëta prej 11%. Eksportet kanë shënuar nivelin rekord me një normë vjetore të rritjes prej 80%, mirëpo struktura e tyre është shumë e ndishme e cila varet nga lëvizjet nëpër tregjet globale. Gjatë vitit 2010 ka pasur rritje edhe në dërgesat e emigrantëve me një normë vjetore prej 1.2% dhe në investimet e huaja direkte me normë vjetore prej 8%, duke veçuar sektorin e prodhimitarisë dhe atë financiar. Asetet e sistemit financiar janë rreth 76% e brutoprodhimit të vendit. Burimi kryesor i financimit të sistemit bankar vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhura në vend. Tregu bankar në Kosovë karakterizohet me normë të lartë të koncentrimin ku tri bankat më të mëdha përfaqësojnë rreth 77% të gjithsej aseteve të sistemit bankar. Në këtë aspekt kërkohet rritje e efikasitetit të sistemit gjyqësor në ekzekutimin e kontratave, avansim i të drejtave pronësore si dhe ngritja e kapaciteteve planifikuese në biznese. Në vitin 2010, përkundër tërheqjes së depozitave nga sistemi bankar rreth 170 milion në emër të dividendës së PTK-së, sistemi bankar i Kosovës ka arritur të shënojë rritje vjetore të depozitave duke ruajtur likuiditetin. Viti 2010 është mbyllur me një sistem bankar të qëndrueshëm, më një nivel të lartë të kapitalizmit, me një cilësi të mirë të portofolios kreditore dhe me një gjendje të kënaqshme të pozitës likuiduese.

Hykmete Bajrami, vlerësoi raportin si profesional ku ofrohen shumë indikacione për sistemin makrofinanciar dhe makroekonomik në Kosovë. Sa i përket raportit në faqen 38 kur flitet për normat e interesit në sistemit bankar dhe për performancën e sistemit bankar, e kundërshton pak shpjegimin kur e jepni lidhur me performancën në rritjen e fitimit, p.sh normat e depozitave kanë pasur rënie, ndërsa normat e interesit janë ngritur që mund të jetë rezultat i ngadalësimit të kredidhënies, përderisa kur flitet për performancën e sistemit bankar ku 32.8 milion ka qenë profiti neto që tregon një rritje prej 29.9% dhe kjo ka qenë si rezultat i rritjes më të shpejtë të kreditimit nga ana e ekonomisë. Lidhur me institucionet mikrofinanciare, të cilat funksionojnë në bazë të linjave kreditore nga fonde me interesa shumë të ulëta dhe donacione, përderisa ofrojnë kredi me norma shumë të larta të interesit. Kjo çështje a do të rregullohet nga mekanizmat e tregut apo do të ndërmerret diçka nga ana e BQK-së? Disa prej institucioneve financiare janë rritur aq shumë duke kërkuar nga BQK-ja që të shndërrohen në banka, ku janë këto kërkesa, sepse një shndërrim i tillë do të kishte ndikuar më pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit. Një çështje tjetër me interes është se nëse nuk arrihet të privatizohet PTK-ja dhe me prishjen e marrëveshjes me FMN-në, Kosova do ta ketë një deficit të lartë buxhetor dhe qeveria do të detyrohet të shfrytëzojë rezervat bankare të shtetit, si do të ndikojë e gjithë kjo në sistemin bankar?

Sali Asllanaj, shprehu shqetësimin për mjetet e privatizimit, kërkoi sqarime për menaxhimin e mjeteve nga fondi i privatizimit për të cilat nuk ka transparencë. A kemi në Kosovë stabilitet të mjaftueshëm financiar që inkasimi i mjeteve të trustit, por edhe të AKP-së të investohen në Kosovë, e jo në kompanitë ndërkombëtare?

Muhamet Mustafa, vlerësoi raportin gjithëpërfshirës që pasqyron gjendjen e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, me përqendrim në sistemin financiar. Sugjeroi që në raportet tjera të paraqitet edhe aktiviteti i Bordit të BQK-së. Sa i përket sektorit financiar, prej vitit 2006 mbetet me akterët e njëjtë duke mos pasur hyrës të ri. Kemi një status quo e cila e shpesh një stabilitet në sektorin financiar, por

duhet të furnizohet sektori real, sidomos bizneset prodhuese me mjete cilësore për investime shumëvjeçare. Nuk është e çuditshme pse kjo situatë ka mbetur e njëjtë, për shkak se kushtet e kredisë janë të tilla të cilat bizneset nuk mund t'i përballojnë për investime afatgjata. Shtrohet pyetja se si do të dalim nga kjo situatë, kur nuk kemi ulje të papunësisë dhe rritje të qëndrueshme ekonomike? Kjo lidhet edhe me ofertën dhe sasinë e parave, në këtë drejtim BQK-ja ka një rol rregullues që do të thotë rritja e konkurrencës dhe bashkëpunimi me qeverinë në mënyrë që në tregun e kredisë të ketë më shumë para. Duhet të preokupohemi me prishjen e status quo me një gjendje konstante afatgjata të normave të interesit në Kosovë, sepse nëse vazhdon kjo, atëherë do të përballemi me krizë sociale, e cila mund të shkaktojë tensione politike dhe do të prishet mjedisi investues. Problemi tjetër është imobilizimi i mjeteve të privatizimit dhe plasimi i tyre, sepse nëse inflacioni është 5.9%, ndërsa mjetet e fondit të privatizimit investohen me 0.21%, atëherë humbet 5% e vlerës së tyre, përderisa Ligji për Agjencinë e Privatizimit, thotë që të ruhet vlera e mjeteve të privatizimit.

Xhevdet Neziraj, vlerësoi përgatitjen e raportit dhe stafin profesional që ekziston në BQK. Pyeti se kur BQK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, do të përgatisin legjislacionin për tregun financiar apo bursën? Për organizatat mikrofinanciare sugjeroi që të bëhet më tepër në rregullimin e statusit dhe veprimtarisë së tyre, kur dihet se ato po marrin donacione dhe po ofrojnë kreditime norma shumë të larta. Këto kredi edhe pse thuhet se janë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për bujqësi, mbi 90%, janë kryesisht kredi konsumuese.

Gani Gërguri, sqaroi se gjatë vitit 2010 ka pasur rënie të normave të interesit në depozita dhe rritje të normave të interesit në kredi, mirëpo ka pasur edhe rritje të kredidhënies që ka ndikuar në profitabilitetin e sistemit bankar. Lidhur me institucionet mikrofinanciare theksoi që BQK-ja nuk ka instrumente për të rregulluar normën e kamatës në tregun financiar si dhe BQK-ja nuk ka pozicion strikt për shndërrimin e institucioneve financiare në banka, sepse ekzistojnë disa kritere që duhet të arrihen duke veçuar strukturën e pronësisë. Sa i përket privatizimit të PTK-së, BQK-ja ka nënshkruar një letër të qëllimit me FMN-në, mirëpo nëse prishet balancimi i paraparë, atëherë natyrisht se do të ketë probleme financiare në vend dhe se BQK-ja nuk ka ndonjë alternativë hipotetike. Paratë e AKP-së janë në Kosovë, përkatësisht në BQK të cilat e përbëjnë portofolion e mjeteve të BQK-së së bashku me mjetet e Qeverisë dhe rezervat e detyrueshme. Këto mjete janë të investuara në bankat korrespondente, në letra me vlerë të Qeverive të BE-së, në depozita të bankave më të mira të BE-së dhe në Bankat Qendrore të BE-së, e gjithë kjo është në pajtim me Ligjin e BQK-së. Këto mjete jemi në gjendje në çdo kohë t'ia sigurojmë AKP-së, mirëpo janë duke u bërë përpjekje që këto mjete të shfrytëzohen edhe në Kosovë në kuptim të përshpejtimin të procesit të likuidimit të ndërmarrjeve tashmë të privatizuara dhe ndarjes së 20%-shit. U pajtua më z.Mustafa që në raportet e ardhshme të përfshihet edhe aktiviteti i Bordit të BQK-së. Si rrjedhojë e kësaj shpërndarja sektoriale e kredive mbetet e pandryshuar dhe modeli i kredidhënies i përshtatet modelit ekzistues të zhvillimit ekonomik në Kosovë. BQK-ja është në përgatitje e sipër të legjislacionit për tregun financiar dhe pritet që në Shtator apo Tetor të përgatitet Ligji mbi licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e Bankave Komerciale, Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare në të cilin do të adresohen problemet e institucioneve mikrofinanciare dhe disa projektligje tjera që janë të parapara në strategjinë legjislative. Letrat me vlerë do të fillojnë të emitohen në tre mujorin e parë të vitit 2012.

Pas diskutimeve, komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010

Betim Gjoshi, sqaroi se buxheti është ndryshuar si rezultat i një mosplanifikimi të duhur dhe ka mbetur një pjesë e obligimeve ende të parealizuara. Sipas mundësive dhe standardeve të Ministrisë së Financave buxheti është shpenzuar racionalisht. Zgjedhjet e vitit 2010 kanë kushtuar 2.5 € për votues në krahasim me vitin 2009, që kanë qenë 3.6 € për votues.

Hykmete Bajrami, jepi vërejtje për shifrat që janë paraqitur në raport të cilat janë shprehur në miliona, përderisa në krye të tabelave janë paraqitur tri zero, që nënkupton se buxheti ka qenë në miliardë. Raporti nuk ka qenë shumë i qartë lidhur me shtesën e buxhetit, sepse kanë qenë të nevojshme të bëhen edhe disa llogaritje. Pyeti për kategorinë e informimit publik që është në vlerë prej 852.240 €, e cila është e lartë, sepse nëse është bërë në RTK, atëherë ka qenë i nevojshëm një memorandum mirëkuptimi. Gjithashtu kërkoi informata për blerjet e veturave që përfshijnë shumën prej 97.431 €. Pyeti se a janë përfshirë komisionerët në listën e të punësuarve, apo janë paraqitur si mallra dhe shërbime?

Kryetarja, ngriti disa çështje, duke veçuar kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ku janë disa pozicione që kanë të bëjnë me udhëtime brenda vendit dhe jashtë vendit si dhe akomodime. Janë paraqitur edhe shpenzime të ndryshme shëndetësore në vlerë prej 1.000 €, duke ditur që nuk ka sigurim shëndetësor dhe nëse kanë pasur të bëjnë me ndonjë shërim atëherë është dashur të shkojnë përmes Ministrisë së Shëndetësisë. Pastaj shpenzimet kontraktuese në vlerë prej 3.631.000 € dhe akomodim blerje në vlerë prej 7.496 € për çka janë përdorur konkretisht?

Betim Gjoshi, lidhur me veturat sqaroi se janë blerë pesë vetura, njëra për kryetaren dhe tjerat janë në vlerë prej 17.000 €. Informimi publik ka të bëjë me minutat që janë blerë nëpër televizionet private të cilat reklama janë transmetuar në pesë gjuhë. Shërbimet kontraktuese kanë të bëjnë me komisionerët dhe stafin kontraktues. Shërbimet shëndetësore kanë të bëjnë me një punëtor i cili ka qenë i plagosur gjatë orarit të punës në Leposaviç dhe një tjetër është vrarë, me ç'rast janë ndarë nga 500 € për secilin.

Miradije Meha, sqaroi për udhëtimet zyrtare jashtë vendit se me kodin e ri të kontabilitetit janë të specifikuar udhëtimet jashtë vendit dhe veçohen akomodimet nëpër hotele. Udhëtimet brenda vendit kanë të bëjnë me takimet e zyrtarëve nëpër komuna.

Pas diskutimeve, Komisioni me nëntë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa) dhe një Abstenim (Albana Fetoshi) nxorri këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2005/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr.04/L-009, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komsioni një zëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

- 7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nr. 04/L-20, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Komsioni një zëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

- 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Komsioni një zëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

- 9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L/010 për noterinë, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion**

Komsioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

- 10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

Komsioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

11. Të ndryshme

11.1 Caktimi i grupit punues për PL për Ndihmë Shtetërore

Pas propozimeve u formua grupi punues me këtë përbërje:

1. Safete Hadërgjonaj
2. Duda Balje
3. Xhevdet Neziraj dhe
4. Albana Fetoshi.

11.2 Raporti me amendamente për PL për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Komisioni njëzëri vendosi amendamnetin 3 që ka të bëjë me çështjen e obligimit të raportimit financiar për shoqëritë tregtare të fshihet dhe të mbetet pika 2 e nenit 4 ashtu si ka qenë në projektligj dhe njëkohësisht komisioni njëzëri miratoi raportin me amendamente të projektligjit në fjalë.

11.3 Raporti i Komisionit lidhur me përmbushjen e detyrave që dalin nga plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2011

Pas diskutimeve komisioni nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Komisioni miratoi planin e veprimit me informatat e pasqyruara dhe i njëjti do të jetë pjesë e raportit të Komisionit për Integritet Evropian në seancën plenare në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj